



Nr. Prot. 268

Tiranë, 26/06/2018

**Kriteret dhe procedurat për pranimet në raundin e I-rë
në programin e studimit *Master i Shkencave në Farmaci*
për vitin akademik 2018 – 2019**

Kuotat dhe kriteret e pranimit

Për vitin akademik 2018- 2019, për programin e studimit *Master i Shkencave në Farmaci* do të vihen në dispozicion 50 kuota për kandidatët shtetas shqiptarë.

Për raundin e I-rë janë parashikuar 40 kuota.

Për programin e studimit *Master i Shkencave në Farmaci*, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë shkollës së mesme.

Vlerësimi i njohurive në raundin e I-rë do të zhvillohet në datën **22 Gusht 2018, ora 16:00**, pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Rr. Dritan Hoxha, Kompleksi Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë".

Aplikimi

Në vlerësimin e njohurive të raundit të I-rë do të marrin pjesë kandidatët që:

1. kanë plotësuar formularin A1 (Matura Shtetërore 2018) ose A1Z (kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm përpara vitit 2017-18) në portalin online të Maturës Shtetërore;
2. kanë përzgjedhur programin e studimit në Farmaci të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në portalin online të aplikimit universitar U-Albania <https://ualbania.arsimi.gov.al/>, në datat 30 Korrik - 4 Gusht;
3. janë të renditur në listën e kandidatëve që kanë përzgjedhur programin e studimit në Farmaci të cilën Universiteti e merr nga portali U-Albania brenda datës 10 Gusht 2018, sipas përcaktimit të Udhëzimit nr.18 dt.21.05.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

Lista e kandidatëve do të afishohet në ambientet e Universitetit dhe do të publikohet në faqen zyrtare www.unizkm.al në datën **10 Gusht 2018**.

Pjesëmarrja në vlerësimin e njohurive

Për të marrë pjesë në vlerësimin e njohurive, brenda datës **22 Gusht 2018 ora 12:00**, kandidatët duhet të:

- **plotësojnë një formular online** në linkun: admissions.unizkm.al, duke bashkëlidhur kopjen e kartës së identitetit ose pashaportës. Në fund të procedurës formulari shkarkohet, printohet¹ dhe firmoset nga kandidati;

¹ Në pamundësi të printimit, plotësimi i formularit do të kryhet në momentin e paraqitjes pranë Zyrës së Pranimeve për kryerjen e pagesës.



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- **paraqiten pranë Zyrës së Pranimeve** të Universitetit për të paguar tarifën e regjistrimit prej 2.000 lekë dhe të dorëzojnë formularin e firmosur.

Pjesëmarrësit duhet të paraqiten pranë Sekretarisë Mësimore 30 minuta përpara fillimit të vlerësimit të njohurive dhe duhet të jenë të pajisur me një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pashaportë).

Vlerësimi i njohurive bëhet në bazë të tre elementeve, me një total prej 80 pikësh si vijon:

1.	<i>Vlerësim me shkrim mbi njohuritë në Shkenca Natyrore (përkatësisht në lëndët Biologji, Kimi, Matematikë, Fizikë)</i>	30 pikë
2.	<i>Vlerësim me shkrim mbi njohuritë në Gjuhën Italiane</i>	20 pikë
3.	<i>Përlllogaritja e notës mesatare të përgjithshme të shkollës së mesme</i>	30 pikë
Total		80 pikë

Renditja e kandidatëve do të bëhet mbi bazën e rezultateve finale individuale, duke ndjekur rendin zbritës të pikëve të fituara.

Lista e renditjes së kandidatëve me ID-në përkatëse do të afishohet në ambientet e Universitetit dhe do të publikohet në faqen zyrtare www.unizkm.al brenda datës **28 Gusht 2018**.

Proçesi i regjistrimit

Kandidatët e raundit të I-rë që janë shpallur fitues, duhet të regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore në datat **30 Gusht deri 12 Shtator 2018**, nga ora 08:00-16:30. Sipas Udhëzimit nr.18 dt. 21.05.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), kjo periudhë është e ndarë në 7 faza. Çdo fazë zgjat 48-orë.

Kandidatit të shpallur fitues i dërgohet një e-mail nga Sekretaria Mësimore ku janë të detajuara dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim dhe afati 48 orësh i kandidatit. Kur kandidati është shpallur fitues, ai duhet të paraqitet pranë Sekretarisë Mësimore brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit për programin e studimit në Farmaci dhe Sekretaria Mësimore thërret automatikisht kandidatin tjetër. Këto faza vijnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 12 Shtator 2018. Nëse gjatë këtij proçesi do të konstatohen kuota të paplotësuara dhe nuk do të ketë kandidatë në pritje, do të rikthehen në garë kandidatët e shpallur fitues në fazat paraardhëse që nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi.

Për t'u regjistruar, kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

- Mandatin e kryerjes së pagesës së këstit të parë apo të këstit të plotë të tarifës vjetore të studimit (urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë, shkarkohet nga portali studenti, zëri Tasse);
- Diplomën e Maturës Shtetërore (origjinale) dhe fotokopjen e noterizuar të saj;
- Lista e notave (origjinale) dhe fotokopjen e noterizuar të saj;
- Vërtetim mjeko - ligjor;
- Çertifikatë familjare;
- Vërtetim banimi;
- Çertifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe në Udhëzimin e MASR nr. 20, datë 22.9.2017 (nëse e disponon);
- 2 foto.

Pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen gjithashtu:

- Kërkesa e regjistrimit (mund të shkarkohet edhe nga portali studenti);
- Deklarata e paraqitur në Shtojcën nr. 1 të Udhëzimit nr. 18 dt. 21.05.2018 (mund të shkarkohet edhe nga portali studenti);
- Kontrata e regjistrimit;
- Formulari i shkarkuar nga portali U-Albania.

Proçesi i çregjistrimit

Kandidati ka të drejtë të çregjistrohet vetëm më datë 13 shtator 2018. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë Sekretarisë Mësimore duke tërhequr dokumentet e dorëzuara.

Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania dhe pranë Sekretarisë Mësimore.

Informacionet në lidhje me zhvillimin e vlerësimit të njohurive për raundin e II-të në programin e studimit *Master i Shkencave në Farmaci* do të komunikohen në vijim nga Zyra e Pranimeve.

Rektori

Prof. Bruno Giardina

